



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 13/09/2017

Proces-verbal nr. 1

Bazuar në Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore”, Neni 38 “Programi buxhetor afatmesëm i rishikuar” pika 2, Sot në datë 13.09. 2017 u zhvilluan takime me banorët e lagjeve 1-18 të qytetit të Korçës.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Ermal Saraçi Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Leonard Gjançi Dr. i Menaxhimit të Kontratave.

Fjalën e mori i pari z. Kletjon Kita, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në qytetin e Korçës dhe Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet : Rikonstruksioni i Voskopojës, rikonstruksioni i Blv “Fan Noli”, “Rikonstruksioni i Pazarit të Vjetër të Korçës, Ndërtimi i “Kompleksit Multifunksional Sportiv dhe Kulturor”, etj.

Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioriteteve për investimet pasi impakti i parë i çdo projekti perceptohet prej tyre.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Programin buxhetor afatmesëm”, qytetarët e Korçës patën hapësirën e nevojshme kohore për të ngritur kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për periudhën 2018-2020. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara. Bazuar në kërkesat e ngritura nga qytetarët u listuan prioritetet si më poshtë:

1. Rikonstruksioni i lulishtes në Lgj. 15 të qytetit
2. Sistemimi i kanalizimeve dhe rrugës “Jani Riza” në Lgj.17 të qytetit
3. Asfaltimi i rrugëve në Lgj 13 të qytetit dhe ndërtimi i terminalit të autobusëve
4. Realizimi i projektit të aerodromit kërkesë e banorëve të Lgj. 2 të qytetit
5. Sistemimi i agjensisë aktuale të qytetit dhe ndriçimi në lulishten në Lgj. 8 të qytetit
6. Ndriçimi i rrugës “Thoma Uaja” të qytetit

7. Rrjeti i kanalizimeve, rrugëve dhe ndriçimit në Lgj. 4 të qytetit (tek ish-fusha e druve)
8. Krahas Qendrave Ditore të Moshës së Tretë krijimi i një hapësire për t'i angazhuar edhe gratë pensioniste me aktivitete të tjera kryesisht artizanati duke e bërë më të kompletuar dhe funksional këtë projekt.
9. Nevoja për vendosjen e puseve në çdo lulishte të qytetit.

Përveç ndërhyrjeve në infrastrukturë të sipërcituara ku banorë të së njëjtës lagje mbështesnin kërkesat e njëri-tjetrit , u sollën edhe sugjerime për projekte në aspektin social.















